



## KPM- 2013/04

Në mbështetje të nenit 3.2.6 të Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media (KPM) nr. 04/L-44, KPM nxjerr:

### RREGULLORJA E KPM-SË PËR DHËNIEN E LICENCËS

#### NENI 1 QËLLIMI

Kjo rregullore përcakton kriteret kualifikuese që kërkohet të plotësojnë kandidatët për Licencë të KPM-së. Në vlerësimin e kërkesave të paraqitura për dhënie të Licencës së KPM-së do të zbatohen kriteret e parapara me nenin 22, paragrafi 4, të Ligjit të KPM-së dhe kriteret shtesë të përcaktuara nga KPM me rastin e shpalljeve publike për frekuenca të reja.

#### NENI 2 ZBATIMI

Kriteret Kualifikuese për Licencë të KPM-së do të zbatohen për të gjithë parashtruesit e kërkesës për Licencë të KPM-së.

#### NENI 3 PËRKUFIZIMET

1. **Licencë:** është leje kontraktuale e dhënë nga KPM-ja për shërbime mediale audio-vizuale. Licenca e obligon të Licencuarin që të veprojë në pajtim me Ligjin e KPM-së, aktet nënligjore të KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe të gjitha ligjet tjera relevante të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
2. **I Licencuari:** është subjekti i pajisur me licencë të lëshuar nga KPM-ja, për të ofruar shërbime mediale audio-vizuale
3. **Pronësi:** Zotërimi i subjektit transmetues i më shumë se 10 përqind (%) të pjesës së kapitalit bazë të një shërbyesi medial audio-vizual dhe/ose të pajisjeve të tij.

4. **Parashtrues i kërkesës:** është çdo subjekt që bën kërkesë për licencë të KPM-së ose ai që kërkon miratim për transferimin e një licence ekzistuese ose miratimin për marrjen e një pjese të pronësisë tek një i licencuar ekzistues.
5. **Personi i autorizuar:** është një individ që përfaqëson dhe zbaton udhëzimet e një të licencuari por jo edhe në emër të një organizate politike.

#### **NENI 4 KRITERET KUALIFIKUESE PËR LICENCË**

Parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë dëshmi dhe të garantojë me shkrim që i përmbahet këtyre kushteve:

1. *Prezencë të ligjshme në Kosovë:* Kompania private ose organizata joqeveritare duhet të jenë fizikisht të pranishme në Republikën e Kosovës dhe të jenë të regjistruar në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, që lidhen me to.
2. Përfaqësuesi i Kompanisë ose organizatës joqeveritare duhet që, me rastin e aplikimit për licencë, të ofrojë dëshmi se është shtetas i Republikës së Kosovës.
3. I Licencuari mund të jetë:
  - 3.1. Kompani private e regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës, ku përfshihen por nuk kufizohet vetëm në to, ndërmarrje e biznesit privat, ortakëri e zakonshme, ortakëri e kufizuar, ndërmarrje aksionare ose me përgjegjësi të kufizuar që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit të programeve përmes radios apo TV;
  - 3.2. Organizatë Jo Qeveritare (OJQ) e regjistruar në bazë të ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, në veprimtaritë e së cilës përfshihet edhe transmetimi i programeve radio apo TV.

#### **NENI 5 KRITERET KUALIFIKUESE PROFESIONALE**

1. Parashtruesi i kërkesës për Licencë duhet të tregojë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një subjekt transmetues në përputhje të plotë me rregulloret e KPM-së, duke përfshirë edhe Kodin e Sjelljes për Shërbimet Medial Audio-vizuele, kushtet dhe termat e përgjithshme të Licencës së KPM-së, standardet teknike dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga KPM-ja;
2. Parashtruesit e kërkesës duhet të tregojnë angazhim dhe aftësi të sigurojnë programe komerciale në mënyrë ligjore, duke respektuar Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;

3. Parashtruesit e kërkesës duhet të tregojnë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një shërbim medial audio-vizuel, çoftë si biznes ose si organizatë joqeveritare.
4. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se posedon kualifikimin superior (universitar) për personin përgjegjës për shërbim programor, çështje teknike dhe për çështje ligjore.

#### **NENI 6 TAKSA**

Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ka kryer të gjitha obligimet lidhur me taksën dhe tatimet në pajtim me legjislacionin e Administratës Tatimore të Kosovës, duke siguruar edhe dëshmi nga Gjykata Ekonomike që nuk ka kontest gjyqësor.

#### **NENI 7 ZBATUESHMËRIA PËR PRONARËT E MEDIAVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Inkurajimi i shumëllojshmërisë dhe i konkurrencës në tregun e mediave në Republikën e Kosovës në shkallë lokale, rajonale dhe nacionale është politikë e KPM-së. Koncentrimi i mediave në Republikën e Kosovës do të rregullohet nga KPM-ja me një akt të veçantë nënligjor.

#### **NENI 8 ZBATUESHMËRIA PËR PRONËSINË E HUAJ**

Pronësia e huaj e një shërbyesi medial audio-vizuel lejohet vetëm në rastin e kompanive komerciale të regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës në përputhje me Ligjin në zbatim.

#### **NENI 9 ARSYET E DISKUALIFIKIMIT PËR MARRJEN E LICENCËS**

1. Licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet:
  - 1.2 partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike;
  - 1.3 personit juridik i cili menaxhohet nga një individ, i cili është i dënuar në një proces në përputhje me standardet ndërkombëtare, për krime që kanë të bëjnë me dhunë apo mashtrime, të cilat nuk i janë falur ligjërisht atij ose asaj.

2. *Entitetet Qeveritare:* Është politikë e KPM-së që të mos u japë Licenca transmetimi agjencive qeveritare, ndërmarrjeve ose entiteteve të tjera në të cilat qeveria ka ndikim në kontrollin e tyre.
3. *Individë që janë të Zgjedhur ose të Emëruar në një Funkcion të lartë Zyrtar:*
  - 3.1. nuk do t'i jepet Licencë një OJQ-je, kryetari, nënkryetari ose drejtori ekzekutiv i të cilës janë të zgjedhur ose të emëruar në funksione të larta zyrtare në nivel qeveritar apo të ndonjë subjekti politik..
  - 2.2. nuk do t'i jepet Licencë një kompanie në të cilën pronësia e shumicës së aksioneve i përkasin një personi të zgjedhur ose të emëruar në funksion të lartë zyrtar qeveritar apo të ndonjë subjekti politik, përveç rasteve kur një person i tillë ka dhënë zyrtarisht dorëheqje nga menaxhimi i shërbyesit medial audio-vizuel.
  - 3.3. Kjo dispozitë nuk do të zbatohet ndaj individëve të punësuar në Shërbimin Civil të Kosovës.
4. *Individët që kanë pozita drejtuese në një Subjekt Politik:* Dispozitat e Paragrafit 7 do të zbatohen njësoj për të gjithë individët që janë të zgjedhur ose janë të emëruar në një post drejtues brenda një subjekti politik. Të njëjtit nuk mund të bartin pozita udhëheqëse në strukturën organizative të parashtruesi për kërkesë për Licencë.
5. *Organizatat dhe Kompanitë e Lidhura me Subjektet Politike:* Nuk do t'i jepet Licencë një OJQ-je ose organizate komerciale që në mënyrë të hapur i kushtohet mbështetjes së një subjekti politik.
6. *Moszbatimi i mëhershëm i Ligjit dhe rregulloreve të KPM-së:* Shkelje serioze dhe të përsëritura të rregulloreve të KPM-së nga një subjekt transmetues, i cili është në pronësi, drejtohet ose financohet nga parashtruesi për kërkesë, përbënë bazë të mjaftueshme për refuzim të Licencës së KPM-së, të re ose të transferuar apo për aprovimin për marrjen e një pjese të pronësisë. Shkelje të tilla merren si fakte të dështimit të vënies në funksion të një shërbyesi medial audio-vizuel në pajtueshmëri me Ligjin, përfshirë edhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së.
7. *Paragjykimet:* Nuk do t'i jepet Licencë një organizate ose ndërmarrje komerciale në rast se ndonjëri nga stafi udhëheqës ka qenë i lidhur me shpërndarjen e materialeve që nxisin urrejtje ose diskriminim, ose që denigrojnë persona në bazë të përkatësisë etnike, origjinës kombëtare, fesë, gjinisë, orientimit seksual ose të paaftësisë fizike.
8. *Personi i autorizuar i të Licencuarit Potencial:* Dispozitat e kësaj rregullore do të zbatohen plotësisht dhe njësoj tek çdo individ, organizatë ose kompani që vepron si person i autorizuar i një të licencuari potencial.
9. *Fshehja e informatave:* Neglizhimi i një kandidati ose të licencuarit për të ofruar informacione që mund ta bëjnë KPM-në që të refuzojë miratimin për modifikimin ose

transferimin e një licence ose të pjesës së pronësisë së një të licencuari, në bazë të kushteve të kësaj Rregulloreje mund të ketë si pasojë dënime të mëvonshme, përfshirë edhe diskualifikimin për marrje të Licencës ose revokimin e Licencës së KPM-së.

10. *Ndryshim i Rrethanave të te Licencuarit:* Çdo ndryshim në gjendjen e zyrtarëve të OJQ-ve ose pronarëve të kompanive që zotërojnë Licencë të KPM-së ose një pjesë të pronësisë, që ka si pasojë diskualifikimin e tyre për Licencë, duhet t'i raportohet KPM-së brenda pesë (5) ditëve pune nga ndryshimi i gjendjes. Një individ i diskualifikuar mund të shkëputet vetë nga i licencuari brenda 30 ditëve nga koha kur ka arritur në pozitë për diskualifikim, përveç rastit kur KPM-ja lejon një periudhë më të gjatë për të bërë rregullimin. KPM-ja do të kërkojë në këto raste të minimizojë rrezikun e çrregullimit të operimit të shërbyesit medial audio-vizuel.

#### **NENI 10 DISPOZITAT KALIMTARE**

Më këtë Rregullore shfuqizohet Rregullorja CIMC-2009/02.

#### **NENI 11 HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe shfuqizon Rregulloren CIMC 2009/02.



Shefki Ukaj

Kryetar i Komisionit të Pavarur i Mediave

28 maj 2013  
Data